




Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 8, paragrafi 1, pika 1.2 dhe nenit 14, paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 10/2019), nenit 5, paragrafi 1, pika 1.3, nenit 6 dhe nenit 13 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10, paragrafi 1 dhe 2, pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005, të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 23.08.2024, merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim afatgjatë

- 1. Miratohet** propozimi i kryetarit të Komunës, Nr. 02/4554/24, i datës 05.08.2024 dhe merret vendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë personit juridik - Drejtorisë për Arsim në Komunën e Rahovecit, për ushtrimin e veprimtarisë arsimore, respektivisht për ndërtimin e çerdhes së fëmijëve.
- 2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekura në pikën 1, të këtij vendimi është:**
 - 2.1.** Parcela sipas certifikatës së pronësisë P-71510057-02680-1, në zonën kadastrale Rahovec, në vendin e quajtur *Kraishta*, me kulturë kullosë e klasës V, në sipërfaqe të përgjithshme prej 5259 m² (pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komunës së Rahovecit.
 - 2.2.** Pjesa e parcelës P-71510057-02680-1, në sipërfaqe prej 2227 m², planifikohet të bëhet parcelimi - të ndahet dhe në këtë pjesë të parcelës të ndërmerren veprimet ndërtimore për ndërtimin e çerdhes.
- 3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është përmirësimi i infrastrukturës - ndërtimi i objektit të çerdhes së fëmijëve për zhvillimin e aktiviteteve edukativo-arsimore për fëmijët e komunës së Rahovecit.**
- 4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatgjatë.**
- 5. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo i çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.**

6. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që sipas detyrës zyrtare të bëjë regjistrimin e pronës në librat kadastral.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen ueb zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- ***Kryetarit të Komunës,***
- ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,***
- ***Drejtorisë për Arsim,***
- ***MAPL-së, dhe***
- ***Arkivit.***

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.243/24
Me datë:23.08.2024

